



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori III 2020

Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	4
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare	4
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	6
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	8
4. Treguesit e shërbimit ekspres.....	9

I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e tretë të vitit 2020 dhe krahasimet me tremujorin e dytë të vitit 2020 dhe me tremujorin e tretë të vitit 2019, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP”-“Shërbimet Postare”
Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e tretë të vitit 2020 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (23 subjekte):**
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S);
 2. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx);
 3. DHL International (Albania) sh.p.k;
 4. TNT Express Albania sh.p.k;
 5. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex);
 6. United Transport sh.p.k (Uni Trans);
 7. Youth Albania Professional Services (YAPS);
 8. E-KOMPLET sh.p.k;
 9. COEX shpk;
 10. Albanian Parcel Distribution shpk;
 11. Speed Couriers Albania (Albi Shkurta – person fizik);
 12. Intex Courier sh.p.k;
 13. Turboo Albania sh.p.k;
 14. Panorama Group sh.a;
 15. Flash Delivery Albania;
 16. Balkan Courier & Logistics sh.p.k.
 17. IVY sh.p.k
 18. Alopost sh.p.k.
 19. Prime Express sh.p.k.
 20. All In One Cool sh.p.k.
 21. Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k.
 22. Fast Delivery sh.p.k
 23. Mr. Courier sh.p.k.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 rezultojnë 7,138,977 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

Tabela 1.1- Të dhëna përmbljedhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara në tremujorin e tretë 2020 dhe krahasimi me tremujorin e dytë 2020 dhe me tremujorin e tretë 2019.


Shërbime postare të ofruara	T3_2019	T4_2019	T1_2020	T2_2020	T3_2020	Ndryshim T3_2020/ T2_2020	Ndryshim T3_2020/ T3_2019
Posta Shqiptare sh.a							
1 Shërbim Universal Postar							
1.1 Postë brenda vendit	4.238.676	5.032.877	4.492.982	3.549.264	4.515.612	27,2%	7%
1.2 Postë ndërkombëtare	3.388.734	304.059	805.709	1.311.731	449.011	-65,8%	-87%
1.3 Totali 1.1+1.2	7.627.410	5.336.936	5.298.691	4.860.995	4.964.623	2,1%	-35%
2 Shërbim joniversal postar							
2.1 Postë brenda vendit	131.101	962.635	12.707	275.266	306.779	11,4%	134%
2.2 Postë ndërkombëtare	314	934	360	47.249	9.173	-80,6%	2821%
2.3 Totali 2.1+2.2	131.415	963.569	13.067	322.515	315.952	-2,0%	140%
3 Shërbim ekspres							
3.1 Ekspres brenda vendit	176.999	123.039	136.068	246.962	283.231	14,7%	60%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	6.223	49.877	5.727	9.450	13.302	40,8%	114%
3.3 Totali 3.1+3.2	183.222	172.916	141.795	256.412	296.532	15,6%	62%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare							
4 Shërbim JoUniversal Postar							
4.1 Postë brenda vendit	186.595	208.183	221.482	484.711	701.719	44,8%	276,1%
4.2 Postë ndërkombëtare	9.771	10.953	9.650	10.609	13.202	24,4%	35,1%
4.3 Totali 4.1+4.2	196.366	219.136	231.132	495.320	714.921	44,3%	264,1%
5 Shërbim ekspres							
5.1 Ekspres brenda vendit	510.385	608.791	588.199	630.510	769.419	22,0%	50,8%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	78.235	64.896	52.892	56.336	77.529	37,6%	-0,9%
5.3 Totali 5.1+5.2	588.620	673.687	641.091	686.846	846.948	23,3%	43,9%
6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	8.727.033	7.366.244	6.325.776	6.622.088	7.138.977	7,8%	-18,2%

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T3 2020

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	5,577,108	78%
<i>Of. e tjerë</i>	1,561,869	22%
<i>Totali</i>	7,138,977	100%

Për sa rezulton nga të dhënat e reflektuara në tabelën 1.2 sa më sipër, për tremujorin e tretë të vitit 2020 Posta Shqiptare zë rreth **78%** të tregut postar përkundrejt Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të cilët së bashku zënë **22%**.

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor




Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, Posta Shqiptare në tremujorin e tretë 2020 ka realizuar 5,577,108 shërbime postare, shifër e cila përkthehet në 137,186 objekte postare më shumë se tremujori i dytë 2020, sikundër ofruesit e shërbimeve postare në tremujorin e tretë 2020 kanë realizuar 379,703 objekte postare më shumë se në tremujorin e dytë të vitit 2020.

Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T3-2020

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
4,964,623	1,030,873	1,143,480	7,138,977
69.5%	14.4%	16%	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 69.5% ose 4,964,623 objekte postare, ndjekur nga shërbimi ekspres me 16% ose 1,143,480 objekte postare. Shërbimi jo universal postar zë 14.4% ose 1,030,873 objekte postare.

Grafiku 1.2 Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet qartë që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar, i cili luhetet në nivelet rreth 70% për tremujorin e tretë të vitit 2020. Nga krahasimi i periudhës T3-2020 me periudhën T2-2020, vërehet një rritje e numrit të shërbimeve postare në masën 516,889 shërbime, sikundër nga krahasimi i tremujorit të tretë të vitit 2020 me tremujorin e tretë të vitit 2019 vërehet një rënie e shërbimeve postare në masën rreth 1,588,056 shërbime.

2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare


Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T3-2020

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	4,515,612
Postë ndërkombëtare	449,011
Totali	4,964,623

Nga të dhënat e tabelës 1.4 vihet re se gjatë tremujorit të tretë 2020, për sa i përket shërbimit Universal Postar, Posta Shqiptare realizoi gjithsej 4,964,623 objekte, nga të cilat Postë brenda vendit 4,515,612 ose 91%, dhe Postë ndërkombëtare 449,011 objekte, ose 9%. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 3,528,275 shërbime për objekte të thjeshta dhe 987,337 shërbime për Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 75,715 objekte postare të pranuar në Shqipëri

dhe të dërguara jashtë vendit dhe 373,296 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 muaj



3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare


Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
Shërbim universal postar	4,964,623	89%
Shërbim jo universal postar	315,952	5.7%
Shërbim ekspres	296,532	5.3%

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 4,964,623 objekte postare ose 89%, i ndjekur nga shërbimi jo universal me 315,952 objekte postare ose 5.7%, dhe shërbimi ekspres me 296,532 objekte postare ose 5.3%.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare gjatë 3-mujorëve të fundit të vitit 2019 dhe 3-mujorëve të vitit 2020, nga ku vihet re një rritje për shërbimin universal dhe për shërbimin ekspres, si dhe një rënie e lehtë për shërbimin jo universal postar krahasuar kjo me tremujorin e mëparshëm.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Sh	315,952	31%
Of. e tjerë	714,921	69%
Totali	1,030,873	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se për sa i përket shërbimit jo universal postar, treguesit më të mirë i kanë Ofruesit e tjerë me 714,921 objekte postare ose 69% të tregut, kundrejt Postës Shqiptare me 315,952 objekte postare ose 31%.

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në tremujorin e tretë 2020 krahasuar me tremujorin e dytë 2020 janë ulur për Postën Shqiptare me 6,563 objekte, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë rritur në mënyrë të ndjeshme me 219,601 objekte. Nga krahasimi mbi bazën e periudhave tremujore, konstatohet rënie e pjesëve të tregut të Postës Shqiptare për këtë shërbim duke arritur në 31% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2019, ku pjesa e tregut të Postës Shqiptare për këtë tregues ishte rreth 40%.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 përbëhej nga 1,008,498 objekte brenda vendit dhe 22,375 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.


5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2020, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2019, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për tremujorin e tretë 2020.

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Shqiptare	296,532	26%
Of. e tjerë	846,948	74%
Totali T3-2020	1,143,480	100%

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Siç vihet re, për sa i përket shërbimit ekspres, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2019, sikundër vërehet rritje në shërbimet postare ekspres për tremujorin e tretë të vitit 2020 e krahasuar kjo me tremujorin paraardhës (T2–2020). Gjithashtu, për shërbimin ekspres vërehet një rritje e pjesëve të tregut për Postën Shqiptare, ku nga rreth 24% të tregut për këtë tregues në tremujorin e tretë të vitit 2019, pjesa e tregut të Postës Shqiptare në tremujorin e tretë të vitit 2020 ka arritur në rreth 26%, përkundrajt rreth 74% të ofruesve të tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 1,052,650 objekte postare ose 92%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 90,831 objekte postare ose 8%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri paraqitet në vlerën 53,596 objekte postare, shifër kjo dukshëm më e madhe se sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit në vlerë 37,077 objekte.